

Antigona (Isak) Asllani

(1997, shqiptare nga fshati Rancë/Rance, komuna e Shtimes/Štimlje)

Albiona (Musë) Asllani

(shkurt 1998, shqiptare nga fshati Rancë/Rance, komuna e Shtimes/Štimlje)

Forcat serbe e kanë bombarduar fshatin Rancë/Rance [Shtime/Štimlje] nga fundi i muajit korrik të vitit 1998. Banorët e kanë braktisur fshatin dhe u strehuan në pyllin e fshatit fqinj të **Grejqefcit/Grejçevce**. Familja Asllani jetonte në një shtator të ngritur nga najloni. Në pyll ishin strehuar disa mijëra njerëz nga fshatrat përreth. Kohë pas kohe, anëtarët e familjes Asllani shkonin në fshat, por të shumtën e kohës e kalonin në tendën e tyre.

Në datën 25.08.1998, forcat serbe i kanë thyer pozicionet e UÇK-së të fshati Duhël/Dulje dhe u nisën drejt fshatit Grejçefc/Grejçevce. Në të njëjtën natë, forcat serbe kanë shtënë edhe mbi pyll, ku ishin të strehuar refugjatët. Në mëngjes, më **26.08.1998**, të shtënat dhe bombardimi u intensifikuan. Kjo i detyroi refugjatët që të fillonin të tërhiqeshin drejt *Livadheve të Gjata/Duge poljane*. Shkonin në formë të kolonës. Familja Asllani gjendej në traktor, të cilin e ngiste Isaku. Me të në kabinë ishte i vëllai Musa, përderisa në rimorkio ishin ulur bashkëshortët e tyre – motrat Halide dhe Ajshe; fëmijet e Isakut dhe e Halides: Lumnija, Luljeta, Antigona, Xhaferi, Shpendi, Ejupi dhe Burimi; vajza e Musës dhe Ajshës, Albiona, si dhe nëna e Isakut dhe Musës, Jalldyze. Kur kolona e refugjatëve arriti te *Livadhet e Gjata/Duge poljane*, forcat serbe hapën zjarr mbi kolonë nga tanket. Një predhë e ka qëlluar rimorkion e traktorit në të cilin gjendej familja Asllani dhe i ka vrarë Haliden, Ajshen, Lumnijën, Luljetën, Antigonen, Xhaferin, Shpendin, Ejupin, Burimin, Albionën dhe Jalldyzen, ndërkaq Isaku dhe Musa vetëm u plagosën. Në të njëjtën natë, Musa me vëllain Jetullahun, dy bashkëfshatarë dhe një pjesëtar të UÇK-së u kthyen në *Livadhet e Gjata/Duge poljane* dhe i varrosën anëtarë të vrarë të familjes Asllani në afërsi të vendit ku kishin pësuar. Në datën 18.10.2000, pjesëtarë të KFOR-it i kanë

zhvarrosur mbetjet mortore të viktimave dhe i kanë çuar në Institutin për Mjekësinë Ligjore në Rahovec/Orahovac. Pas obduksionit, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të viktimave në varrezat e fshatit Rancë/Rance. Për nder të viktimave është ngritur edhe përmendorja.

Burimet: deklarata H.B, FDH-2541; deklarata H.B, FDH-2544; deklarata J.A, FDH-22771; deklarata A.B, FDH-23607; deklarata M.A, FDH-25906.

Fehmi (Asllan) Bokaj-Sami

(19.02.1955, shqiptar nga Grejçefci/Grejçevce, komuna e Suharekës/Suva Reka, bujk, pesë fëmijë)

Naim (Qerim) Bokaj

(8.01.1978, shqiptar nga Grejçefci/Grejçevce, komuna e Suharekës/Suva Reka, bujk, i pamartuar)

Në muajin qershor të vitit 1998, banorët e Grejçefcit/Grejçevce u strehuan në pyll përmbi fshat. Jetonin në tenda najloni. Në mesin e tyre kishte edhe refugjatë nga fshatrat përreth. Në datën **26.08.1998**, kur vërejtën se forcat serbe po i afroreshin pyllit, Naimi dhe Fehmiu me familje të veta dhe refugjatë të tjerë u nisën drejt fshatit Topillë/Topilo [Shtime/Štimlje]. Në kolonë ishin afro 180 njerëz. Kur arritën te *Livadhet e Gjata/Duge poljane [Grejçefc/Grejçevce]*, forcat serbe kanë hapur zjarr mbi kolonën. Në fillim, Fehmiu tentonte të gjente strehim nga të shtënat buzë përroskës së afërt, por kur tentoi që të kthehej te traktori, e qëlluan në kërdhokull. Naimi iu afrua që t'i ndihmonte dhe, në atë çast, një granatë e qëllou Fehmiun për vdekje. Pas pak, edhe Naimi u qëllua për vdekje. Trupat e tyre kanë mbetur në vendin e vrasjes për dy ditë. Më pas, djali dhe vëllai i Fehmiut me disa pjesëtarë të UÇK-së i kanë varrosur viktimat në *Livadhet e Gjata/Duge poljane*. Pas përfundimit të luftës, në muajin gusht të vitit 1999, mbetjet e tyre mortore u rivarrosën në varrezat e Grejçefcit/Grejçevce.

Burimet: deklarata H.B, FDH-2541; deklarata H.B, FDH-2544; deklarata H.B, FDH-11401; deklarata H. B, FDH-2543; deklarata M.B, FDH-2526; FDH, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor, FDH-24707.